

INVESTITORË KUJDES:

Ndaj aktivitetit të shoqërisë me emrin Fortrade

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) paralajmëron investitorët për rrezikun ndaj shërbimeve të shoqërisë që operon me emrin Fortrade nëpërmjet adresës së internetit <https://www.fortrade.com>.

Mbështetur në Ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për Titujt” dhe Vendimin nr. 55 datë 30.03.2011 “Për njohjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë”, një shoqëri brokerimi e huaj lejohet të ofrojë shërbimet e saj në vendin tonë, përmes një “agjenti” të themeluar si shoqëri brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pas miratimit nga AMF.

Shoqëria Fortrade, e cila ofron për tregun shqiptar instrumente financiare nuk është e licencuar nga Autoriteti për të ofruar shërbime investimi në Republikën e Shqipërisë.

Për këtë arsye, Autoriteti i bën thirrje investitorëve të bëjnë shumë kujdes përpara se të marrin një vendim në lidhje me pranimin e një oferte të kryer nëpërmjet telefonatave ose mjeteve të tjera të komunikimit për t'i nxitur ata të regjistrohen ose hapin llogari në platformën online të **shoqërisë Fortrade**, nëpërmjet faqes së saj të internetit <https://www.fortrade.com>. Çdo komunikim nëpërmjet telefonit, email-it, apo mjeteve të tjera, që përfaqëson një ftesë ose marketing për të investuar në platformën online me emrin **Fortrade**, është i jashtëligjshëm.

Publiku duhet të jetë i qartë se Autoriteti nuk monitoron ligjshmërinë e aktivitetit të **shoqërisë Fortrade** dhe nuk mund të mbrojë interesat e të gjithë atyre, që investojnë në subjekte apo platforma të palicencuara, siç është edhe platforma me emrin **Fortrade**.

Autoriteti është në komunikim të vazhdueshëm me institucionet e tjera ligjzbatuese për të ndaluar aktivitetin e shoqërive të palicencuara.

Lista e shoqërive të licencuara nga AMF për ofrimin e shërbimeve për investime gjendet në faqen zyrtare të AMF-së në Rubrikën *Regjistri i të Licencuarëve/Tregu i Titujve*.

Nëse subjekte të palicencuara nga AMF ju kontaktojnë për t'ju ofruar produkte dhe/ose shërbime financiare, ju lutem të na kontaktoni në amf@amf.gov.al apo në numrin e telefonit + 355 (0) 4 2257560.